



Meritokraci - Integritet - Transparencë - Liri akademike

Platformë për drejtimin e Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë

HYRJE

Të nderuar kolegë dhe studentë!

Përmes këtij komunikimi me ju, gjej rastin t'ju falënderoj për përkrahjen dhe mbështetjen e treguar, sugjerimet dhe idetë e ofruara gjatë kësaj periudhe kandidimi! Gjithashtu, gjej rastin të falënderoj kolegët e mi kandidatë për drejtues të fakultetit tonë, për mbarëvajtjen e mirë të fushatës zgjedhore si dhe për performancën, integritetin moral dhe profesional dinjitoz që shfaqën në vazhdimësi!

Si kandidate për të drejtuar Fakultetin e Edukimit dhe të Filologjisë, e ndjej përgjegjësi dhe privilegj të ndaj me ju vizionin tim për zhvillimin e mëtejshëm të këtij Fakultetit, si një nga Fakultetet themelues të këtij Universiteti, në një kohë kur për Universitetin e Korçës, por edhe për universitetet e tjera publike në vend, vështirësitë dhe sfidat janë objektive dhe të njohura nga ne të gjithë.

Fakulteti ynë ka në themel bashkëpunimin institucional dhe njerëzor, që udhëhiqet nga respekti për idetë e tjetrit, toleranca, mirëkuptimi, integritimi, qytetaria dhe përkushtimi, ka stafin akademik me kredenciale akademike në nivelet që kërkon meritokracia dhe konkurrenca, në nivel rajonal e më gjerë, është bartës dhe zhvillues i gjallë i debatit, i të menduarit kritik, dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore.

Programet e paraqitura nga të gjithë kandidatët janë të mbushur plot me ide novatore dhe vullnetin për të të bërë më të mirën e mundshme për zhvillimin e mëtejshëm të Fakultetit tonë, familjes sonë të madhe dhe të përbashkët, ndërsa unë dua ta nis nga diçka konkrete që besoj se prek gjithsecilin prej nesh: ***meritokracinë, integritetin, transparencën dhe lirinë akademike***, si elemente parësorë në bashkëpunimin dhe zhvillimin e punës në fakultet. Kjo pikënisje, lidhet me përvojën time shumëvjeçare në Fakultet si dhe eksperiencat e tjera profesionale.



Meritokracia. Ne jetojmë në një kohë dhe një vend ku shpeshherë vihet re një ndarje jo e drejtë mes atyre që bëjnë punën dhe atyre që marrin meritat. Personalisht, kam pëlqyer përherë të jem në grupin e vogël, por kompakt të atyre që bëjnë punën, por si drejtuese do t'i jap përparësi faktit që meritat të shkojnë tek ata që realisht e bëjnë punën dhe japin më të mirën prej vetes, duke u shpërblyer me të drejtë.

Transparenca, një element që karakterizoi punën time si drejtuese e departamentit të Gjuhë-Letërsisë, është një pikë jo më pak e rëndësishme, sepse vendimet transparente, që

diskutohen me të gjithë aktorët, që nuk lënë mënjanë dhe nuk përjashtojnë askënd që mund ta mendojë ndryshe, kontribuojnë në krijimin e një bashkëjetese aq të nevojshme për t'i dhënë harmoni punës së gjithsecilit. Në këtë pikë, për të qenë plotësisht transparente me ju të gjithë, më duhet të pranoj që programi për drejtimin e një fakulteti është vetëm një skicim idesh në letër, që shpesh janë asgjë, pa atë frymë të nevojshme që lidh të gjithë palët, në interes të së mirës së përbashkët. Dhe besoj që e mira jonë e përbashkët lidhet me punën, vlerësimin, arritjet profesionale të stafit akademik dhe me studentët që janë limfa jetike e Universitetit tonë.

Integriteti dhe liria akademike. Në qendër të propozimeve të mia për shndërrimin e Fakultetit, kam pasur dhe kam mbështetjen individuale të secilit pedagog për një dinjitet njerëzor e profesional. Shpresoj të kem konsensusin tuaj në këto propozime që synojnë ndihmën e mbështetjen ndaj çdo pedagogu në karrierën e vet. Esenca e lirisë akademike qëndron në të drejtën dhe përgjegjësinë e pedagogut në formatimin e programit mësimor, menaxhimin e lëndës dhe veprimtarive që lidhen me procesin mësimor, vlerësimin e studentëve, në orientimin e kërkimit shkencor individual. Por, shpesh marrëdhënia e pedagogut me departamentin dhe fakultetin, reduktohet në orën që ai vjen ose ikën nga ndërtesa, me orët që ai qëndron i ngujuar në zyrë para kompjuterit, apo në llogaritjen e orëve të dhëna ose jo mësim. Në vend të kësaj praktike veprimtaria e pedagogut do të matet me kritere të tjera të veprimtarisë dhe prodhimit akademike, punën kërkimore dhe botimet, pjesëmarrjet në projekte kombëtare e ndërkombëtare, veprimtari në ndihmë të promovimit të programeve të studimit, botimeve të monografive apo teksteve për studentët etj.

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj platforme, nuk është të tregojë se është më e mirë sesa platformat e tjera, por të nxitë në krijimin e kushteve optimale për stafin e fakultetit dhe studentët

tanë. Komunikimi dhe bashkëpunimi mes nesh, forcimi i zërit tuaj në vendimmarrjet kolegjiale, respektimi i autonomisë së brendshme dhe krijimi i kushteve për rritjen dhe zhvillimin tuaj profesional, do jenë ato që do drejtojnë punën time në vitet në vijim. Vizioni im për katërvjeçarin e ardhshëm të fakultetit konsiston në modernizimin e tij të gjithanshëm, në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së procesit mësimor dhe të punës kërkimore, duke e bërë institucionin tonë gjithnjë e më konkurrues në sistemin e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë dhe të hapësirës shqiptare në tërësi.

Në funksion të këtij vizioni përpjekjet e mia së bashku me stafin, gjatë këtij mandati do të përqëndrohen në këto drejtime kryesore:

1. Rritjen dhe garantimin e autonomisë së Fakultetit në funksion të realizimit të objektivave të zhvillimit të institucionit;

2. Lehtësimin e procedurave për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve. Eliminimi i burokracive do të sjellë lehtësimin e procedurave në menaxhimin e projekteve duke u mbështetur te delegimi i kompetencave për aplikimin dhe menaxhimin e projekteve kërkimore e shkencore, nga njësitë bazë dhe pedagogët e fakultetit.

3. Ngritjen e një grupi pune mbështetës për shkrimin e projekteve brenda fakultetit, në bashkëpunim edhe me strukturën përkatëse në Rektorat. Ky ka për të qenë kusht për thithjen reale të projekteve me një fokus të gjerë dhe e të shtirë në të gjitha departamentet. Kjo platformë e konsideron të rëndësishme ngritjen dhe mbështetjen e grupeve të tilla kërkimore, të cilat do të krijojnë kushte për zhvillimin dhe nxitjen e projekteve shkencore si dhe të bashkëpunimit midis kolegëve dhe studiuësve.

4. Akreditimin e programeve tona akademike. Platforma konsideron se akreditimi ka të bëjë me shkallën e seriozitetit akademik të një institucioni, ndaj dhe krijimi i kushteve për vlerësimin dhe akreditimin e programeve tona të studimit, i shërben rritjes së seriozitetit dhe reputacionit të këtij Fakulteti brenda dhe jashtë Shqipërisë.

5. Hapjen e programeve të reja të studimit bazuar mbi kërkesat e njësive bazë. Si drejtuese e departamentit Gjuhë-Letërsisë, këmbëngula dhe bashkë me kolegët ia dolëm mbanë të hapim jo vetëm program dyvjeçar, por edhe Masterin e Shkencave **Media Kulturë Editim**, i pari master në llojin tij në panoramën e gjithë universiteteve publike në vend. Lobimi i vazhdueshëm mundësoi që ne të kemi një premisë që sheh edhe më lart, tek synimi **për hapjen e Ciklit të tretë të studimeve doktorale**, çka do t'i japë Fakultetit një strukturë më të plotë brenda zhvillimit universitar në vend.

Kjo frymë që e zbatova me sukses në departamentin e Gjuhë-Letërsisë, synoj të përhapet edhe në departamentet e tjera, duke i nxitur të gjithë kolegët dhe studentët të shohin lart, drejt arritjeve më të mira në të ardhmen e Fakultetit tonë.

6. Krijimin e një grupi pune brenda departamentit, për promocijonin e programeve të studimit me qëllim tërheqjen e një numri sa më të madh studentësh në këto programe. Ky grup pune, në marrëveshje me departamentin do të ketë lehtësi dhe ndihmesë nga gjithë stafi për realizimin e misionit të vet me sukses

7. Përmirësimin e infrastrukturës së institucionit. Krijimi i kushteve dhe ambienteve sa me komode për stafin akademik dhe atë ndihmës.

8. Disponueshmëri të dokumentacionit. Kjo platformë beson se një ndër indikatorët tregues të seriozitetit të një universiteti dhe Fakulteti është aksesimi dhe disponueshmëria e dokumenteve që qëndrojnë në bazë të ndarjes së autoritetit dhe pushtetit, marrëdhënieve mes strukturave drejtuese, si dhe marrëdhënieve të Fakultetit me individë studenët, prindër, apo pedagogë, si dhe marrëdhëniet me institucione dhe aktorë brenda apo jashtë vendit.

9. Përditësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të faqes online të Fakultetit, nëpërmjet pasqyrit të gjithë aktivitetit të tij akademik dhe kulturor.

10. Përmirësimin e trajtimit financiar të personelit akademik dhe atij mbështetës.

Stafi akademik

Në qendër të propozimeve të mia kam mbështetjen individuale ndaj secilit pedagog **për arritje akademike e profesionale**. Shpresoj të kem konsensusin tuaj në këto propozime që synojnë ndihmën e mbështetjen ndaj çdo pedagogu në karrierën e vet:

1. Akordimi në bashkëpunim me departamentet e një lejeje nga mësimdhënia për një periudhë të paktën 1 muaj, për secilin pedagog që po mbyll dosjen e tij të doktoratës, profesorit të asociuar apo profesorit.

2. Dhënien në mënyrë automatike të të gjitha lejeve individuale për pjesëmarrje në konferenca a aktivitete shkencore jashtë vendit.

3. Mbështetje maksimale për aplikimin dhe dhënien e “Sabbatical”. Kjo platformë konsideron se Fakulteti ynë duhet të përqafojë praktikën më të mira të fakulteteve nëpër botë, për sa i përket stimulimit dhe mbështetjes së prodhimit akademiko-shkencor të pedagogëve. Praktikimi i “Sabbatical”, dhënies leje të paguar një pedagogu, për t’u marrë dhe për të përfunduar një projekt kërkimor shkencor, hyn në këtë pozicionim dhe kjo platformë e sheh si një ndër rrugët e stimulimit të pedagogëve tanë për t’u angazhuar në projekte dhe studime shkencore.

4. Kontrata automatike për të paktën dy vite për çdo profesor që mbush moshën e pensionit dhe njohje e statusit të profesorit.

5. Ndihmë për karrierën akademike të çdo pedagogu përmes rrjetëzimit me universitete rajonale në vendet si Itali, Greqi, Rumani, Bullgari, nisur edhe nga lidhjet e kontaktet e mia personale dhe profesionale me disa universitete, ku do të mundësohen organizimet e projekteve dhe konferencave ndërkombëtare të përbashkëta, që janë të nevojshme për kualifikimet e kërkuesve për stafin tonë akademik, në aspektin e fitimit të gradave dhe titujve shkencorë, si dhe të eksperiencës së vlefshme në mësimdhënie në auditorë universitetesh të huaja.

Studentët

Studentët janë potenciali më i rëndësishëm i Fakultetit tonë, ata që motivojnë punën e secilit prej nesh dhe përpjekjen për përmirësimin apo hapjen e programeve të studimit sa më funksionale dhe në përshtatje me kërkesat dhe interesat e tyre. Krahas punës së realizuar në vite, programi im për studentët parashikon:

1. Krijimin e një ure komunikimi të qëndrueshme me studentët me qëllim lehtësimin e aksesit nga ana e tyre në tregun e punës;

2. Vendosja e studentëve dhe interesave të tyre në epiqendër të interesimit të të gjitha hallkave drejtuese të fakultetit. Për këtë qëllim, kujdes i veçantë do të tregohet për:

a. intensifikimin e bashkëpunimit dhe konsultimit me përfaqësuesit legjitimë të studentëve.

b. përmirësimin dhe thjeshtimin e procedurave për akses më të shpejtë në sistemin e vlerësimit dhe të kontrollit.

c. krijimin e mundësive të reja për pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari shkencore të fakultetit.

ç. përmirësimin e mëtejshëm të kushteve për veprimtari kulturore, sportive dhe argëtuese të studentëve.

d. krijimin e një tradite të shëndoshë të shkëmbimeve studentore mes fakultetit tonë dhe universiteteve të tjera të trojeve shqiptare.

e. Rritjen e numrit të mobiliteteve studentore në kuadër të programeve Erasmus+, por gjithashtu edhe në sajë të rritjes së bashkëpunimeve dypalëshe nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara me institucione të huaja të arsimit të lartë.

3. Krijimin e mundësisë për studentët për ndjekjen e shkollave verore.

4. Krijimin e rrjetit të Studentëve Vullnetarë në nivel fakulteti. Studentët e këtij rrjeti do jenë pjesë e të gjithë aktivitetit dhe funksionit të zyrave administrative dhe ambienteve të Fakultetit, duke i përfshirë ata që nga procesi i planifikimit e deri në realizimin e aktiviteteve. Një strukturë e tillë do të rritë frymën e bashkëpunimit mes studentëve, mes stafit dhe studentëve, si një urë lidhëse e drejtpërdrejtë për përcimin e problematikave dhe zërit të tyre pranë strukturave tona, por mbi të gjitha do t'u japë studentëve një eksperiencë bashkëpunimi që zhvillon aftësitë ndër personale, aq shumë të rëndësishme në tregun e punës.





Kjo përfshirje e studentëve në rrjetin e vullnetarizmit, me shërbime në mbështetje të procesit mësimor dhe administrativ të Fakultetit, duke përzgjedhur studentët më të zellshëm për t'u përfshirë në këtë proces, do t'u mundësojë vetë studentëve të përfshirë që të krijojnë një eksperiencë të vyer paraprake mbi aplikimin në procese të ndryshme pune, njëherësh do të jetë një hallkë

që do të afrojë më shumë shërbimet e Fakultetit tek studentët e tjerë. Të gjithë studentët e përfshirë në këtë rrjet do të pajisen edhe me dokumentacion vlerësues si praktikë vullnetare pranë Fakultetit, në shenjë mirënjohje për kontributin e tyre.

5. Krijimin e forumit Student-Art, rrjetit artistik të fakultetit, me aktivitete të parashikuara çdo vit në fushën e letërsisë, muzikës, teatrit. Ky rrjet do të mundësojë përvijimin e një tradite të bukur të fakultetit, sepse disa nga studentët tanë kanë arritur që të realizojnë veprimtari shumë të bukura brenda fakultetit dhe në ambiente të tjera si Teatri i qytetit të Korçës, muzeu “Bratko”, “Mësonjëtorja e parë shqipe” etj.

6. Krijimin e lehtësirave për studentët që të kenë një zyrë brenda ambienteve të Fakultetit ku të zhvillojnë debatet, diskutimet, takimet studentore. Kjo lloj autonomie ka për të dëshmuar besimin tonë tek vlerat dhe meritat e studentëve.

7. Pasurimin e jetës studentore me aktivitete sociale, kulturore, sportive. Do të parashikohet çdo vit një kalendar vjetor me aktivitete, i cili më pas do të pasurohet me propozimet e studentëve dhe stafit, përgjatë vitit akademik. Veç aktiviteteve kulturore dhe artistike, vend të veçantë do kenë edhe aktivitetet sportive përmes kampionateve në nivel fakulteti dhe institucional në disiplina të ndryshme sportive, duke synuar gjithashtu një bashkëpunim të ngushtë edhe me institucione të tjera të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë.



8. Trajtimi i veçantë i studentëve të ekselencës dhe mbajtja e lidhjeve të ngushta dhe të vazhdueshme me Qendrën e karrierës për të promovuar në vijimësi arritjet profesionale të këtyre studentëve.

9. Zhvillimi i trajnimeve, uorkshop-eve, leksioneve të hapura me ekspertë të ftuar, etj. për zhvillimin e mëtejshëm profesional të studentëve.

10. Mbështetja ndaj studentëve dhe këshillit studentor të Fakultetit. Fuqizimi i

zërit të studentëve në të gjitha strukturat e përcaktuara në ligj në funksion të përmirësimit dhe angazhimit real të tyre do jetë prioritet gjatë këtij 4-vjeçari.

11. Krijimin e Lehtësirave në jetën Urbane për studentët. Kjo përfshin angazhimin për paraqitjen e një kërkesë Bashkisë së Korcës, në rang institucional, për të mundësuar akseset lehtësuese për studentin përsa i përket transportit publik (pajisjes me abone) apo frekuentimit të institucioneve socialkulturore, me çmime të reduktuara (teatër, kinema, stadium, ekspozita, panaire etj.)

Biblioteka e Fakultetit



Biblioteka e fakultetit tonë meriton të jetë biblioteka më e rëndësishme e gjithë universitetit, nisur nga profilet e programeve tona të studimit dhe puna e çmuar me kontribute botuese e pedagogëve të fakultetit tonë. Në këtë aspekt, do të punohet;

a. për zgjerimin e ambienteve të bibliotekës aktuale;

b. për funksionimin me kohë të zgjatur me dy turne, që biblioteka të jetë përherë në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik;

c. për zgjerimin dhe pasurimin e fondit me literaturë të përzgjedhur në ndihmë të stafit akademik dhe të studentëve.

d. përbibliotekën dixhitale që do të jetë mbështetje e madhe për studentët dhe stafin akademik, në përshtatje edhe me metodologjinë e re të mësimdhënies që përfshin mësimdhënien online.

Të dashur kolegë!

Unë kam bindje të plotë se synimet e lartpërmendura mund të arrihen. Mund të arrihen sepse fakulteti ynë ka një staf akademik të kualifikuar dhe një traditë të mirë drejtimi, prandaj një falenderim i merituar shkon sot edhe për drejtuesit e deritanishëm të fakultetit, të cilët me punën e tyre plot përkushtim, kanë krijuar një pikëmbështetje solide për të çuar përpara institucionin drejt synimeve të reja.

Unë dua t'ju garantoj se në themel të filozofisë sime të drejtimit të fakultetit do të jetë krijimi i një atmosfere të shëndoshë pune, i një klime të vërtetë bashkëpunimi, tolerance e mirëkuptimi, ku secili nga ne të ndjehet i realizuar e optimist. Nëse ju të nderuar kolegë e studentë, me vullnetin tuaj të lirë, më jepni shansin për të qenë në drejtim të fakultetit për katër vjetët e ardhshëm, unë kam vetëm një përgjigje për ju:

do të jem plotësisht e përkushtuar për të justifikuar besimin tuaj, tërësisht e vendosur për të realizuar synimet e parashtruara më sipër.
Ju përhëndes të gjithëve dhe ju uroj suksese të reja!

Me respekt
Prof.as. Jonela Spaho